



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE/
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË, KOSOVO POLJE



Datë: 16.06.2025

**KORNIZA AFATMESME BUXHETORE KOMUNALE
(KABK)
2026 – 2028**

1. Qëllimi

Korniza Afatmesme Buxhetore Komunale (KABK) 2026-2028 paraqet dokumentin kryesor mbi bazën e të cilit do të hartohet Buxheti Vjetor për vitin 2026. Qëllimi kryesor i KABK-së është që të ofrojë një analizë të bazuar të mjedisit makroekonomik në vend, për të vendosur kështu bazën për planifikimet buxhetore për vitet që vijnë në përputhje me prioritetet strategjike të Qeverisë.

Kjo kornizë e buxhetit për vitet 2026-2028 bazohet në KASH 2026-2028 që është aprovuar nga Qeveria e Kosovës. Korniza është hartuar në bazë të Strategjisë Komunale për Zhvillimin Ekonomik 2016-2020, Qarkores Buxhetore 2026/01 të lëshuar nga MFPT, Qarkores së Brendshme Buxhetore Komunale 2026/01, LMFPP të nenit 20. Duke marrë parasysh se procesi i regjistrimit të popullsisë ka përfunduar, ju njoftojmë se kufijtë buxhetorë të përcaktuar në këtë qarkore janë bazuar në të dhënat zyrtare të regjistrimit të popullsisë, të publikuar nga Agjencia e Statistikave të Kosovës në vitin 2024, dhe të aprovuara me Vendimin e Qeverisë Nr. 08/251, datë 12.03.2025. Komuna (DBF) ka për detyrë ta dorëzojë këtë kornizë tek Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, të aprovuar nga Kuvendi Komunal, deri më **30 Qershor të vitit aktual**.

2. Objektivat e Kornizës Afatmesme Buxhetore Komunale

Korniza Afatmesme Buxhetore për periudhën 2026–2028 planifikohet në bazë të Buxhetit, i cili bazohet në “Buxhetin e programeve” dhe është i bazuar në objektivat e Komunës. KAB Komunale 2026–2028 është krijuar në përputhje me udhëzimet e Qarkores Buxhetore nr. 2026/01, e cila sfond të vetin dhe kontekst ka prioritet e programeve dhe kursimet e shpenzimeve.

Objektivat e Komunës:

- Mbrojtja, përmirësimi i ambientit dhe infrastrukturës së qytetit;
- Përfshirja e tërësishme në arsimin parashkollor, fillor dhe të mesëm, si dhe ngritja e nivelit të arsimit;
- Zhvillimi i fushës së shëndetësisë dhe mirëqenies sociale;
- Zhvillimi i fushës së kulturës, rinisë dhe sportit;
- Promovimi dhe përkrahja e bizneseve të vogla dhe të mesme;
- Përkrahja e të rinjve dhe ulja e papunësisë;
- Subvencionimet në bujqësi;
- Përkrahja e OJQ-ve në përgjithësi, e në veçanti organizatat e të rinjve.

Me qëllim të përmbushjes së kërkesës së Qeverisë për përgatitjen e buxhetit në kohën e duhur, thelbësore është që të gjitha drejtoritë të veprojnë në pajtim me afatet kohore dhe kërkesat e specifikuara në këtë Kornizë. KAB Komunale paraqet një mjet të procesit për zhvillimin e buxhetit, që bën ndërlidhjen e planeve, politikave dhe resurseve në dispozicion me prioritetet e komunës, me qëllim që të demonstrojë qëndrueshmërinë e programeve komunale gjatë periudhës së ardhshme trevjeçare, si dhe projekteve të cilat ndihmojnë në realizimin e prioriteteve të Qeverisë, të përcaktuara në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim 2016-2021. KAB duhet të përcaktojë këto fusha përkatëse për tri vitet vijuese fiskale:

- Vlerësimin e të hyrave nga të gjitha burimet;
- Vlerësimet e hershme (nëpër kategoritë ekonomike);

- Programi i investimeve publike.

Në KAB janë paraqitur tabelat që prezantojnë shpërndarjen e grantit, projeksionin e të hyrave të drejtorive nga të gjitha burimet, investimet kapitale, ndarja e buxhetit sipas programeve dhe nënprogrameve, si dhe masat dhe rekomandimet tjera, etj.

3. Shpërndarja e Grandeve

Në tabelat e poshtë cekura (1,2) kemi të dhënat e shpërndarjes së grandeve për komunën tonë, të aprovuara nga Komisioni i Grandeve, që është mbajtur në muajin prill të këtij viti, nga Qarkorja Buxhetore 2026/1, nr. pr. 1508/2025 të dates 15.05.2026 të lëshuar nga Ministria e Financave Punës dhe Transfereve.

➤ Granti i përgjithshëm

Granti i Përgjithshëm për komuna për vitin 2026 është aprovuar nga Komisioni i Granteve në shumë prej 345 milionë euro.

Kjo ndarje bazohet në formulën e përcaktuar në nenin 24 të LFPL. Sipas këtij neni, 10% e të hyrave totale të buxhetuara të Qeverisë qendrore ju ndahen komunave, Me qëllim të nivelizimit të kapacitetit të ulët të të hyrave vetanake të komunave më të vogla, bazuar në LFPL, secila komunë do të pranojë për çdo vit një shumë të përgjithshme fikse prej 140,000 euro, duke zbritur nga 1 euro për kokë banori ose 0 euro për komunat me popullsi të barabartë ose më të madhe se 140,000 banorë. Pas kësaj, shpërndarja e bërë nëpër komuna bazohet në formulën për alokimin e grantit të përgjithshëm në komuna sipas LFPL: (i) numri i popullsisë llogaritet me tetëdhjetë e nëntë përqind (89%); (ii) përmasat gjeografike të komunës me gjashtë përqind (6%); (iii) numri i popullsisë pakicë në komunë me tre përqind (3%); (iv) komunat ku shumica e popullsisë së të cilave përbëhet nga pakicat me dy përqind (2%).

➤ Granti Specifik për Arsim sipas LFPL

Granti Specifik për Arsim para universitar sipas LFPL, bazohet në sistem të hapur të financimit, duke marrë parasysh kriteret në formulën e arsimit para universitar të MASHTI për vitin 2026-2028.

Granti specifik për arsim para universitar për vitin 2026 është aprovuar në shumë prej 270.46 milion euro si vijon:

- Paga dhe shtesa në shumë prej 247.4 milion euro,
- Mallra dhe shërbime në shumë prej 16.75 milion euro,
- Investime kapitale në shumë prej 2.1 milion euro.

Politikat e reja të aprovuara janë si në vijim:

- a) Transporti i nxënësve nga klasa 0-9, me kosto prej 3.48 milion euro,

b) Numri i personelit ndihmës për çerdhet e reja, rritje të stafit prej 138 dhe kosto për paga dhe shtesa prej 0.9 milion euro.

Formula trajton nivelin e arsimit parafillor, fillor dhe të mesëm, duke marrë për bazë këto kriterë:

- a) Numri i nxënësve të regjistruar për vitin 2024/2025;
- b) Raporti nxënës-mësimdhënës për arsimin fillor dhe të mesëm për nxënësit shumicë
1:21.3
- c) Raporti nxënës-mësimdhënës për arsimin fillor dhe të mesëm për nxënësit pakicë
1:14.2;
- d) Raporti nxënës-mësimdhënës për arsimin parashkollor 1:12;
- e) Raporti nxënës-mësimdhënës për arsimin e mesëm profesional për nxënësit shumicë
1:17.2, dhe për nxënësit pakicë 1:11.5;
- f) Raporti nxënës-mësimdhënës për zonat malore 1:14.2;
- g) Kalkulimi për stafin mësimdhënës të gjuhës angleze për klasën I dhe II;
- h) Kalkulimi për stafin teknik administrativ për 630 nxënës 1 staf në arsimin parafillor dhe fillor;
- i) Kalkulimi për stafin teknik administrativ për 470 nxënës 1 staf në arsimin e mesëm
- j) Kalkulimi për stafin ndihmës për 170 nxënës 1 staf (pastrues) si dhe 1 staf për shkollë (roje);
- k) Kalkulimi i pagave dhe shtesave është bazuar në Ligjin për Paga në sektorin Publik;
- l) Shërbimi profesional Pedagogjik/Psikologjik;
- m) Koordinatorët e cilësisë;
- n) Mallrat dhe shërbimet janë kalkuluar sipas kriterit për nxënës (23 euro për nxënës shumicë dhe 25 euro për nxënës pakicë) dhe për shkollë (1,500 euro për shkollë parafilllore dhe fillore dhe 3,250 euro për shkollë të mesme);
- o) Kapitalet janë kalkuluar sipas kriterit 7 euro për nxënës;

Sipas MASHTI-të është raportuar numri për 12,961 nxënës më pak në arsim para universitar krahasuar me vitin paraprak.

Me Qarkoren Buxhetore Komunale 2025/02 do të bëhet rishikimi dhe harmonizimi i stafit në sektorin e arsimit para-universitar.

➤ Granti specifik për Shëndetësi Primare

Granti Specifik për shëndetësi primare sipas LFPL, bazohet në sistem të hapur të financimit, duke marrë parasysh kriteret në formulën e shëndetësisë primare të MSH për vitin 2026-2028.

Granti specifik për shëndetësi primare për vitin 2026 është aprovuar në shumë prej 87.52 milion euro, si në vijim:

1. Granti bazë në shumë prej 85.77 milion euro, ii cili është kalkuluar duke marrë për bazë:

- I. Kategorinë paga dhe shtesa në sektorin e shëndetësisë në shumë prej
64.16 milion euro,
- II. Kategorinë mallra dhe shërbime në shumë prej 19.57 milion euro
- III. Shpenzime komunale në shumë prej 2.03 milion euro.

2. Politika e re e aprovuar për vitin 2026 është:


V. Intervenimi në fëmijërinë e hershme në shumë prej 1.74 milion euro dhe staf shtesë prej 192, nga të cilët

- a. Logoped 48,
- b. Psikolog 48,
- c. Fizioterapeut 48, dhe
- d. Punëtor social 48.

Tabela 1. Shpërndarja e Granteve dhe të Hyrave Komunale 2026-2028

Organizata buxhetore	Buxheti	Plani i buxhetit për vitet		
	2025	2026	2027	2028
Granti i Përgjithëshem	5,916,282.00	12,603,039.00	13,575,325.00	14,665,952.00
Granti i Arsimit	5,530,790.00	7,221,020.00	7,437,651.00	7,660,780.00
Granti i Shëndetësisë	1,841,091.00	2,555,776.00	2,632,449.00	2,711,422.00
Të Hyrat Vetanake	3,459,675.00	4,423,751.00	4,713,766.00	4,727,669.00
Huamarrja në Shëndetësi		-		
TOTALI	16,747,838.00	26,803,586.00	28,359,191.00	29,765,823.00

% E RITJES SË GRANTEVE, THV DHE BUXHETIT PËR VITIN 2026-2028



4. Projektionet e të Hyrave Vetanake Komunale për vitin 2026 dhe parashikimet 2026-2028

Projeksionet e të hyrave vetanake komunale në shkallë vendi për vitin 2025 bazuar, në vlerësimet makro-fiskale, janë në shumë prej 123.5 milion euro. Këto të hyra i shtohen financimit komunal krahas granteve komunale. Të hyrat komunale të Komunës sonë realizohen në bazë të Rregullores për Tarifa dhe Ngarkesa Komunale,

Rregullores për Tatimin në Pronë si dhe dispozitave tjera ligjore, (Ligji për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal nr.03-L-049) të cilat përcaktojnë llojet e ndryshme të të hyrave komunale, me të cilat Komuna ka të drejtë të caktojë dhe inkasojë të hyrat komunale:

Tabela 2. Parashikimi i të hyrave buxhetore komunale 2026-2028

Burimet e të Hyrave	Buxheti	projeksionet	
	2026	2027	2028
Grantet qeveritare	22,379,835.00	23,645,425.00	25,038,154.00
Totali i të H.Vetanake	4,423,751.00	4,713,766.00	4,727,669.00
Taksa për regjistrimin e automjeteve	180,000.00	181,000.00	181,600.00
Taksa Komunale për leje ndërtimi	1,600,000.00	1,610,000.00	1,625,000.00
Taksa për Regjistrimin e Trashëgimisë-bartja e pronës	86,000.00	86,500.00	90,000.00
Taksë Admini.(Certifik.lind.,kurorëzim., vdekjes,shtet., etj)	50,000.00	52,000.00	53,000.00
Taksa Administrative -Fletëkërkesat	12,800.00	13,000.00	13,500.00
Taksa për legalizimin e objekteve	37,000.00	37,800.00	38,500.00
Taksa për leje rrënimi	9,800.00	10,000.00	11,000.00
Taksa ndërimi i destinimit të tokës	175,000.00	177,000.00	185,000.00
Taksë për certifikata të pronësisë dhe kopje plani	100,000.00	110,000.00	120,000.00
Leje mjedisore Komunale	177,500.00	180,000.00	185,000.00
Regjistrimi i pengut - hipoteka	25,000.00	25,500.00	26,000.00
Gjobat nga inspektorati	6,200.00	6,350.00	7,000.00
Inspektimet (ushqimore, higjieniko - sanitare, veterinë, etj)	10,000.00	10,200.00	10,800.00
Të hyrat nga shërbimet e ndryshme (qiraja, etj.)	2,500.00	2,700.00	2,800.00
Të hyrat nga shërb. e ndryshme (Kopja e pl.,)			
Të hyrat nga tatimi në pronë	1,144,460.00	1,227,434.00	1,239,708.00
Të hyrat nga tatimi në tokë	269,231.00	325,769.00	327,398.00
Të hyrat nga arsimit	140,000.00	155,000.00	170,000.00
Të hyrat nga shëndetësia	85,000.00	95,000.00	100,000.00
Të tjera -	413,260.00	408,513.00	341,363.00
TOTALI ;	26,803,586.00	28,359,191.00	29,765,823.00

5. Buxhetimi i programeve

Do të bëhet sipas programeve dhe nënprogrameve të Administratës, të Arsimit dhe të Shëndetësisë. Nga drejtorët do të kërkohet të përcaktojnë se në cilat programe do të bëhet shpërndarja e fondeve, si dhe shumën që do të vihet në dispozicion me buxhet për secilin program. Transferet në mes të programeve do të kufizohen gjatë vitit buxhetor 2026, ndërsa Drejtorët e Programeve do të jenë përgjegjës dhe të autorizuar për bërjen e shpenzimeve nga programet e tyre.

Buxhetet Komunale 2026-2028 do të përgatiten nëpër të gjitha kategoritë ekonomike për shpenzimet e buxhetuara, të definuara sipas Thesarit, e që janë: "Paga dhe shtesa", "Mallra dhe shërbime", "Shpenzime komunale", "Subvencione dhe transfere" dhe "Shpenzime kapitale".

6. Shfrytëzimi i Vlerësimeve të Hershme

Ky buxhet aktual nënkupton që kostoja e vlerësuar e programeve të vazhdueshme komunale do të publikohet për buxhetin në dy vitet vijuese (këto dy vite referohen si vlerësime të hershme). Edhe pse publikohet buxheti trevjeçar, vetëm fondet për vitin aktual buxhetor do të ndahen në bazë të parasë së gatshme, shih tabelën nr. 3,4,5.

Tabela 3. Planifikimi i Buxhetit për vitin 2026

Kodet e Progr am.	Programet/ nën-programet	Stafi 2026	Pagat dhe Shtesat	Mallrat dhe Shërbimet	Shpenzimet Komunale	Subvencionet dhe Transferet	Investimet Kapitale	Totali
16002	Zyra e Kryetarit	22	205,556.20	33,000.00		50,000.00		288,556.20
16302	Administrat a dhe Personeli	25	228,330.75	69,200.00			100,000.00	397,530.75
16422	Regjistrimi civil	8	70,544.73	5,000.00				75,544.73
16502	Çështjet gjinore	2	17,259.51	2,000.00		10,346.00		29,605.51
16542	Integri Evropiane	6	58,622.71	4,100.00				62,722.71
16603	Inspektimet	18	193,191.84	60,060.00				253,251.84
16902	Zyra e Kuvendit Komunal	31	325,590.11	20,000.00				345,590.11
17502	Buxhet dhe Financa	17	166,263.94	12,806.00			200,000.00	379,069.94
18002	Infrastruktura rrugore	9	95,279.95	14,450.00			2,800,000.000	2,909,729.95

18162	Shërbimet publike	15	154,813.36	990,933.12	210,000.00	91,000.00	2,535,000.00	3,981,746.48
18210	Sherbimet e zjarrfikësve	5	44,303.49	5,000.00				49,303.49
19710	Zyra komunale për komunitete dhe kthim	7	59,718.55	6,970.00		3,000.00		69,688.55
47042	Bujqësia dhe zhvillimi rural	13	138,192.34	90,750.00		350,000.00		578,942.34
48002	Zhvillimi ekonomik	13	118,855.91	20,430.00		80,000.00	500,000.00	719,285.91
65010	Kadastra dhe Gjeodezia	7	64,815.80	23,180.00				87,995.80
65410	Prona	7	72,301.04	5,750.00				78,051.04
66015	Planifikimi urban dhe mjedisi	15	157,369.21	139,000.00			0.00	296,369.21
85002	K.R.dhe Sportet	15	137,261.61	73,000.00		231,375.00	1,395,000.00	1,836,636.61
73011	Administrat a e shëndetësis ë	7	70,234.34	252,620.00	80,000.00	370,000.00	810,000.00	1,582,854.34
73150	Shërbimet e shëndetesis ë primare	194	1,208,340.41	417,500.00				1,625,840.41
75506	Shërbimet sociale	20	172,834.62	48,650.00	10,000.00	30,030.00		261,514.62
92010	Administrat a e arsimit	9	106,081.43	160,106.00		493,000.00	2,171,000.00	2,930,187.43
92230	Arsimi parashkollo r (çerdhet)	84	568,740.97	90,300.00	30,500.00			689,540.97
93030	Arsimi fillor, i	696	5,764,238.11	417,217.00	61,700.00			6,243,155.11

	mesëm i ultë							
94230	Arsimi i mesëm i lartë	95	899,571.95	95,100.00	36,200.00			1,030,871.95
TOTALI		1,340	11,098,312.88	3,057,122.12	428,400.00	1,708,751.00	10,511,000.00	26,803,586.00

Shpërndarja grafike e Buxhetit për vitin 2026




Tabela 4. Planifikimi i Buxhetit për vitin 2027

Kodet e Progr am.	Programe t/ nën-programe t	Stafi 2027	Pagat dhe Shtesat	Mallrat dhe Shërbimet	Shpenzimet Komunale	Subvencionet dhe Transferet	Investimet Kapitale	Totali
16002	Zyra e Kryetarit	22	241,194.84	35,000.00		55,000.00		331,194.84
16302	Administra ta dhe Personeli	26	231,101.20	71,250.00			52,691.00	355,042.20
16422	Regjistrimi civil	8	71,131.53	6,300.00				77,431.53
16502	Çështjet gjinore	3	26,714.11	3,200.00		11,000.00		40,914.11
16542	Integri Evropiane	6	31,437.39	4,450.00				35,887.39
16603	Inspektim et	18	194,473.19	60,450.00				254,923.19
16902	Zyra e Kuvendit Komunal	31	326,126.50	35,000.00				361,126.50
17502	Buxhet dhe Financa	20	189,519.53	13,105.00			300,000.00	502,624.53
18002	Infrastrukt ura rrugore	10	96,300.26	14,825.00			2,004,000.000	2,115,125.26
18162	Shërbimet publike	15	155,020.50	1,215,253.25	235,000.00	93,000.00	3,185,000.000	4,883,273.75
18210	Sherbimet e zjarrfikësve	5	44,672.69	5,562.00				50,234.69
19710	Zyra komunale për komunitet e dhe kthim	7	60,075.44	7,592.35		3,500.00		71,167.79
47042	Bujqësia dhe zhvillimi rural	13	139,204.54	93,125.00		490,000.00		722,329.54

48002	Zhvillimi ekonomik	13	118,855.91	21,225.00		82,000.00	550,000.000	772,080.91
65010	Kadastra dhe Gjeodezia	7	65,327.32	23,320.00				88,647.32
65410	Prona	7	72,750.20	6,215.00				78,965.20
66015	Planifikimi urban dhe mjedisi	16	168,625.54	141,200.00				309,825.54
85002	K.R.dhe Sportet	15	137,450.30	85,260.30		232,575.00	1,930,000.00	2,385,285.60
73011	Administra ta e shendetësi së	7	70,912.62	251,000.00	81,000.00	373,000.00	750,000.000	1,525,912.62
73150	Shërbimet e shëndetesi së primare	200	1,414,954.58	500,267.00				1,915,221.58
75506	Shërbimet sociale	20	176,897.85	49,135.00	10,000.00	31,000.00		267,032.85
92010	Administra ta e arsimit	11	107,560.23	160,620.53		415,000.00	1,740,800.00	2,423,980.76
92230	Arsimi parashkoll or (çerdhet)	94	678,430.97	91,235.00	42,000.00			811,665.97
93030	Arsimi fillor, i mesëm i ultë	720	6,315,715.35	418,435.00	61,700.00			6,795,850.35
94230	Arsimi i mesëm i lartë	100	995,752.85	151,394.13	36,300.00			1,183,446.98
TOTALI		1,394	12,130,205.44	3,464,419.56	466,000.00	1,786,075.00	10,512,491.00	28,359,191.00

Shpërndarja grafike e Buxhetit për vitin 2027





Tabela 5. Planifikimi i Buxhetit për vitin 2028

Kodet e Program.	Programet/nën-programet	Stafi 2028	Pagat dhe Shtesat	Mallrat dhe Shërbimet	Shpenzimet Komunale	Subvencionet dhe Transferet	Investimet Kapitale	Totali
16002	Zyra e Kryetarit	23	242,232.00	40,000.00		60,000.00		342,232.0
16302	Administrata dhe Personeli	28	260,230.50	72,000.00				332,230.5
16422	Regjistrimi civil	9	71,553.42	7,000.00				78,553.4
16502	Çështjet gjinore	3	26,792.20	4,000.00		13,000.00		43,792.2

92230	Arsimi parashkollor (çerdhet)	95	593,200.50	94,500.00	41,000.00		100,000.000	828,700.5
93030	Arsimi fillor, i mesëm i ultë	725	6,549,818.65	490,350.00	61,800.00		1,600,000.000	8,701,968.6
94230	Arsimi i mesëm i lartë	105	1,005,752.85	243,658.25	37,000.00			1,286,411.1
TOTALI		1,419	12,815,790.75	3,990,929.55	496,800.00	2,023,000.00	10,439,302.70	29,765,823.0

Shpërndarja grafike e Buxhetit për vitin 2028



8. Programi i Investimeve (Kapitale) Publike – PIP

Në tabelën nr.6 janë paraparë investimet kapitale për periudhën tre vjeçare. Këto propozime janë vlerësime të hershme të cilat mund të ndryshohen nga kërkesat e qytetarëve, brenda kufijve buxhetor. Nga drejtoritë do të kërkohet të përgatisin analizat e PIP për të gjitha projektet e investimeve publike. Propozimet që nuk përmbajnë analizat e PIP nuk do të merren parasysh për financim. Propozimet e PIP do të përfshijnë si

16542	Integri Evropiane	6	31,513.52	50,000.00				81,513.5
16603	Inspektimet	18	194,554.45	65,500.00				260,054.4
16902	Zyra e Kuvendit Komunal	31	326,260.50	43,000.00				369,260.5
17502	Buxhet dhe Financa	20	189,572.20	13,500.00			884,910.28	1,087,982.4
18002	Infrastruktura rrugore	12	97,412.16	15,000.00			1,242,723.420	1,355,135.5
18162	Shërbimet publike	16	156,135.32	1,480,000.00	260,000.00	96,000.00	3,115,000.000	5,107,135.3
18210	Shërbimet e zjarrfikësve	5	60,250.35	6,000.00				66,250.3
19710	Zyra komunale për komunitete dhe kthim	8	61,212.60	8,000.00		40,000.00		109,212.6
47042	Bujqësia dhe zhvillimi rural	13	139,450.60	97,500.00		500,000.00		736,950.6
48002	Zhvillimi ekonomik	13	122,629.23	23,350.00		90,000.00	500,000.000	735,979.2
65010	Kadastra dhe Gjeodezia	7	65,327.32	24,220.00				89,547.3
65410	Prona	8	66,527.40	6,820.50				73,347.9
66015	Planifikimi urban dhe mjedisi	16	168,672.13	143,500.00				312,172.1
85002	K.R.dhe Sportet	15	137,475.25	92,350.50		300,000.00	2,050,000.00	2,579,825.7
73011	Administrata e shëndetësisë	8	71,232.32	253,000.00	85,000.00	400,000.00	500,000.000	1,309,232.3
73150	Shërbimet e shëndetësisë primare	204	1,923,562.30	501,125.30			446,669.000	2,871,356.6
75506	Shërbimet sociale	20	176,897.85	51,235.00	12,000.00	34,000.00		274,132.8
92010	Administrata e arsimit	11	77,525.13	165,320.00		490,000.00		732,845.1

ato për shqyrtim të financimit nga BKK dhe të Hyrat Vetanake ashtu edhe ato që propozohen për financim nga donatorët. Ato duhet të përfshijnë projekte që do të niseshin në vitet 2026, 2027 dhe 2028, jo vetëm projektet që fillojnë në vitin 2026.

Ne kërkojmë nga drejtorët e drejtorive që të fillojnë me përgatitjen e kërkesave të tyre për projektet kapitale, sa më herët që është e mundur, kjo do të ndihmonte në shmangien e vonesave pasuese! Propozimet e projekteve që janë dorëzuar në procesin e PIP - it vitin e kaluar por që nuk janë financuar, mund të dorëzohen sërish.

Tabela 6. Programi Komunal i Investimeve Publike (PIP) 2026 – 2028

Nr .	Kod. Fun.	K o . p r.	Emri i Projektit	Plan i 2026 nga i cili:			Projeksi. 2027	Projeksi. 2028
				Kostoja totale	Transferet qeveritare	Të hyrat vetanake		
I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX
			SHPENZIMET KAPITALE TOTALE	10,511,000.00	7,796,000.00	2,715,000.00	10,512,491	10,439,303.00
			612163 - Administrata dhe Personeli	100,000.00	50,000.00	50,000	52,691.00	-
			16302 -Administrata					
1	0133		Blerja e makinave për pastrim të dysHEMEVE në objektet e Administratës, Shëndetësisë dhe Arsimit	100,000.00	50,000.00	50,000.00	52,691.00	-
			612175 - Buxhet dhe Financa	200,000.00	200,000.00		300,000.00	884,910.00
2	0112		Bashkëfinancimi i projekteve të ndryshme sipas prioritetit të Komunës, Impianti i ujërave të zeza, dhe projektet nga Donatorët dhe Ministritë e Linjes.	200,000.00	200,000.00		300,000.00	884,910.00
			612480 – Zhvillimi Ekonomik	500,000.00	430,000.00	70,000.00	550,000.00	500,000.00
			48002-Zhvillimi Ekonomik Lokal		430,000.00	70,000.00		
3	0411		Sistemi Solar në institucionet e - Administratës, QKMF-së, dhe Arsimit	200,000.00	130,000.00	70,000.00	300,000.00	500,000.00
4	0411		Renovimi i objekteve banesore në rrugën "Bedri Pejani" Lagjja Bresje, Fushë-Kosovë	300,000.00	300,000.00		250,000.00	-
			612180 - Shërbimet Publike, Mbrojtja Civile, Emergjenca	2,535,000.00	1,690,000.00	845,000.00	3,185,000.00	3,115,000.00
			18162 – Infrastrukturë Publike		1,690,000.00	845,000.00		

5	0451	Impianti i ujërave të zeza - Kolektori	100,000.00	100,000.00		180,000.00	200,000.00
6	0451	Blerja e automjetit (Kamion me korpë, Cisternë për pastrim të rrugëve)	230,000.00	80,000.00	150,000.00	400,000.00	-
7	0451	Ndërtimi i urave në fshatrat: "Pomozotin", "Miradi e Poshtme" dhe "Vragoli"	95,000.00	95,000.00		120,000.00	-
8	0451	Ndërtimi i rrugëve bujqësore me zhavor dhe kanaleve kulluese të ujërave atmosferike nëpër Vendbanime në: Fushë-Kosovë dhe fshatrat: Kuzmin, Miradi e Epërme, Miradi e Poshtme, Vragoli, Henc, Harilaq, Sllatinë e Madhe, Sllatinë e Vogël, Bardh i Madh, Bardhi i Vogël, Graboc, Pomozotin, Lismir, Nakaradë	250,000.00	100,000.00	150,000.00	305,000.00	450,000.00
9	0451	Ndërtimi i kanalizimeve atmosferike në Fushë-Kosovë dhe fshatra	100,000.00		100,000.00	200,000.00	350,000.00
10	0451	Ndërtimi i rrethojave me infrastrukturë përcjellëse në varrezat e qytetit të Fushë-Kosovës, fshatrave "Miradi e Epërme" dhe "Sllatinë e Madhe"	300,000.00	300,000.00		150,000.00	-
11	0451	Nërtimi i pikave grumbulluese për mbeturina në Fushë-Kosovë	130,000.00	130,000.00		150,000.00	200,000.00
12	0451	Riparimi i rrugëve të asfaltuara nëpër Vendbanime (Në Fushë-Kosovë dhe fshatrat: Kuzmin, Miradi e Epërme, Miradi e Poshtme, Vragoli, Henc, Harilaq, Sllatinë e Madhe, Sllatinë e Vogël, Bardh i Madh, Graboc, Pomozotin, Lismi, Nakaradë)	450,000.00	300,000.00	150,000.00	480,000.00	500,000.00
13	0451	Vendosja e ndriçimit publik dhe mirëmbajtja e tërsishme, në Fushë-Kosovë dhe Fshatra	260,000.00	165,000.00	95,000.00	300,000.00	350,000.00
14	0451	Shenjëzimi horizontal dhe vertikal i rrugëve në qytet dhe fshatra	170,000.00	170,000.00		250,000.00	300,000.00

15	0451		Ndërtimi i kanalizimeve në fshatrat "Sllatinë e Madhe" dhe "Sllatinë e Vogël"	200,000.00		200,000.00	300,000.00	300,000.00
16	0451		Ndërtimi i ujësjellësit në fshatin Harilaq - Loti II	250,000.00	250,000.00		350,000.00	465,000.00
18002-Infrastrukturë Rrugore				2,800,000.00	1,800,000.00	1,000,000.00	2,004,000.00	1,242,723.00
17	0451		Ndërtimi i parqeve, hapësirave të reja rekreative, dhe këndi i lojërave nëpër vendbanime në: Fushë - Kosovë dhe Fshatra	350,000.00	350,000.00		350,000.00	100,000.00
18	0451		Mbjellja e pemëve dekorative, dhe vendosja e ulëseve dhe shportave nëpër vendbanime, (qytet dhe fshatra)	85,000.00		85,000.00	100,000.00	100,000.00
19	0451		Ndërtimi dhe riparimi i trotuareve nëpër vendbanime, (në Fushë-Kosovë dhe fshatrat: "Miradi e Epërme", "Miradi e Poshtme", "Vragoli", "Sllatinë e Madhe", "Lismir", "Bardh i Madh", dhe "Graboc")	150,000.00	150,000.00		250,000.00	269,723.00
20	0451		Rregullimi në rrugën Dardania Fushë-Kosovë (trotualet , ndriçimi, largimi i terrasave, sinjalizimi, infrastruktura elektrike) - Lot II	550,000.00	350,000.00	200,000.00	-	-
21	0451		Rikonstruimi i rrugëve me: trotuare, ndriçim, infrastruktura elektrike në rrugët " Hajrullah Zymi" dhe "Enver Maloku" - Lot II	50,000.00		50,000.00	-	-
22	0451		Rregullimi i hapësirave me: trotuare, ndriçim, gjelbërim në Rr. "UÇK" - Bardh i Madh, Sllatinë e Vogël, Sllatinë e Madhe, Pomozotin, dhe Graboc - Lot II	200,000.00	200,000.00		-	-
23	0451		Ndërtimi i rrethojave për siguri në komunikacion në fshatrat: "Vrogoli" dhe "Sllatinë e Madhe" - "Ruga e Pejës-M9"	60,000.00	60,000.00		-	-

24	0451	Asfaltimi në Fushë-Kosovë: Rugët "Pajazit Islami" me infrastrukturë përcjellëse, "Xheladin Idrizi"	200,000.00		200,000.00	100,000.00	-
25	0451	Asfaltimi në Fushë-Kosovë: Rruga "Tahir Zemaj" me infrastrukturë përcjellëse"	200,000.00	200,000.00		300,000.00	300,000.00
26		Asfaltimi në Fushë-Kosovë: Rugët "Amir Elmazi" – Lot II, "Ymer Prizreni"	200,000.00	200,000.00		50,000.00	-
27	0451	Asfaltimi në Nakaradë – Rugët: "Fehmi Lladrovci" dytësore-krah	30,000.00		30,000.00	50,000.00	80,000.00
28	0451	Asfaltimi në Fushë-Kosovë ("Lagjja 028"- 029"): Rruga "Pashko Vasa"	150,000.00	90,000.00	60,000.00	-	-
29	0451	Asfaltimi në Graboc: Rr. "Sogojeva"	35,000.00		35,000.00	30,000.00	-
30	0451	Asfaltimi në Bardh të Madh – Rugët: "Qyqalla", "Nënhekurudha"-dytësore, "UÇK Bardhi ", "Rashica"	50,000.00		50,000.00	35,000.00	-
31	0451	Asfaltimi në Bardh të Vogël: Rruga "Lisi"	20,000.00		20,000.00	30,000.00	30,000.00
32	0451	Asfaltimi në Sllatinë të Madhe: Rugët "Rruga e Pejës" - dytësore, "Udha e Malit"	40,000.00		40,000.00	39,000.00	30,000.00
33	0451	Asfaltimi në Sllatinë të Vogël: Rugët: 1 Tetori - dytësore	20,000.00		20,000.00	30,000.00	45,000.00
34	0451	Asfaltimi në Vragoli, Rugët: "Butrinti", "Mahalla e Lartë", "9 Prilli", "Livadheve ", "Lidhja e Pejës"	30,000.00		30,000.00	30,000.00	40,000.00
35	0451	Asfaltimi në Miradi të Epërme: Rugët: "Bregu i Madh", "Lumi ", "Gërvalla", "Dëshmori"	30,000.00		30,000.00	40,000.00	50,000.00
36	0451	Asfaltimi në Harilaq – Rruga - "Otava"	20,000.00		20,000.00	30,000.00	35,000.00
37	0451	Asfaltimi në Henc : Rruga "Abdyl Henci" - Dytësore	20,000.00		20,000.00	20,000.00	26,000.00

38	0451	Asfaltimi në Lismir: Rugët "Tahir Mehaj", "Ejup Gashi"	50,000.00		50,000.00	30,000.00	32,000.00
39	0451	Asfaltimi në Kuzmin: Rugët "Meshari", "Dimitrie Tocovic"	20,000.00		20,000.00	30,000.00	40,000.00
40	0451	Asfaltimi në Pomozotin: Rruga "Kroi"- Dytësore , degëzimet 1,2,3	10,000.00		10,000.00	30,000.00	30,000.00
41	0451	Asfaltimi në Miradi të Poshtme: Rugët "Miradi", "Graçanka", "Bllata", "Bardhosh Gërvalla", "Ylli i Dritës", "Përtej Lumit", "Gjin Gazulli"	30,000.00		30,000.00	30,000.00	35,000.00
42		Asfaltimi të "Parku rekreativ" të Pishat në fshatin "Sllatinë e Vogël"	200,000.00	200,000.00		400,000.00	-
612730 - Shëndetësia dhe Mirëqenia Sociale			810,000.00	810,000.00		750,000.00	946,669.00
43	0721	Blerja e paisjeve për shëndetësi për QKMF - në Fushë-Kosovë	190,000.00	190,000.00		250,000.00	446,669.00
44	0721	Blerja e Autoambulancës për QKMF Fushë-Kosovë	100,000.00	100,000.00			
45	0721	Ndërtimi i QMF-së - Faza e II Rr. Gjergj Fishta (pjesa e mbetur e oborrit)	20,000.00	20,000.00			
46	1060	Ndërtimi i shtëpisë për përkujdesjen e të moshuarve në fshatin "Miradi e Poshtme" Fushë-Kosovë	500,000.00	500,000.00		500,000.00	500,000.00
612850 - Kulturë, Rini dhe Sport			1,395,000.00	1,295,000.00	100,000.00	1,930,000.00	2,050,000.00
47	0820	Renovimi dhe zgjerimi i stadiumit të qytetit "Ekrem Grajqevci" Fushë-Kosovë - Faza e II-të	215,000.00	135,000.00	80,000.00	350,000.00	350,000.00
48	0820	Ndërtimi i pllakave memorjale (në varrezat e dëshmorve Fushë-Kosovë)	60,000.00	40,000.00	20,000.00	80,000.00	100,000.00
59	0820	Renovimi i fushave të futbollit me bari sintetik tek shkollat: "B. Curri" - Henc, "V. Frasheri"-Vragoli, "Z. Salihu" - Pomozotin, "Lismiri"- Lismir	320,000.00	320,000.00		500,000.00	600,000.00

50	0820		Ndërtimi i qendrës multifunktionale me objektet përcjellëse Rr."Nëna Tereza"	800,000.00	800,000.00		1,000,000.00	1,000,000.00
612920 - Arsime dhe Shkencë				2,171,000.00	1,521,000.00	650,000.00	1,740,800.00	1,700,000.00
51	0912		Blerja e paisjeve për shkollat fillore në Fushë-Kosovë	200,000.00	150,000.00	50,000.00	300,000.00	400,000.00
	0911		Ndërtimi i shkollës në Fushë-Kosovë Faza II rr. Fazli Grajqevci	241,000.00	241,000.00		-	-
52	0912		Renovimi i objekteve shkollore. Shkollat: "Bajram Curri", "Mihal Grameno", "Mihal Grameno anex II", "Daut Bogujevci", "Vllezërit Frashëri", Zenel Salihu", "Hivzi Sulejmani"	350,000.00	280,000.00	70,000.00	240,800.00	200,000.00
53	0912		Ndërtimi i çerdhës në rrugën "Shukri Obertinca" Faza II	230,000.00		230,000.00	-	-
54	0912		Dixhitalizimi në objektet shkollore (Blerja e smart boards për realizimin e orës mësimore në formë vizuale) për shkollat fillore	300,000.00	300,000.00		-	-
55	0912		Instalimi i pompave termike në Institucionet Edukative Arsimore: "Gëzimi Ynë", "Mihal Grameno Anex I, Anex II" "Daut Bogujevci"	400,000.00	400,000.00		400,000.00	200,000.00
56	0912		Ndërtimi i sallave shkollore në shkollën "Mihal Grameno" Anex III, dhe shkollën e re Rr. "Fazli Grajqevci" Fushë-Kosovë				500,000.00	500,000.00
57	0912		Ndërtimi i shkollës fillore në fshatin Lismir, Fushë-Kosovë	200,000.00		200,000.00	200,000.00	300,000.00
58	0911		Ndërtimi i Çerdhës në Sllatinë të Madhe dhe Miradi e Epërme	250,000.00	150,000.00	100,000.00	100,000.00	100,000.00

9. Fazat e procesit buxhetor 2026 - 2028

Pjesa në vijim prezanton kalendarin kohor të buxhetit komunal dhe ofron një përmbledhje të hapave dhe veprimeve që kërkohen gjatë procesit buxhetor komunal 2026 – 2028.

Hapi 1: Shqyrtimi i prioriteteve nga drejtoritë komunale

Ky hap kërkon nga drejtoritë që të bëjnë shqyrtimin e çështjeve rreth politikave dhe prioriteteve në fushat e tyre të përgjegjësisë. Në pajtim me prioritetet e gjera të komunës (kur janë në dispozicion) secila drejtori duhet të ofrojë gjithashtu listën përmbledhëse të propozimeve të politikave të reja me prioritet që do të propozohen për procesin buxhetor komunal 2026 - 2028 (d.m.th. që pritet të fillojnë për çdo vit), bashkë me opsionet për kursimet e mundshme në programet e prioritetit të ulët dhe me performancë të dobët.

Shqyrtimi i prioriteteve do t'iu mundësojë drejtorive që të garojnë në procesin e përcaktimit të prioriteteve në një fazë të hershme të procesit për zhvillimin e buxhetit dhe para se të merren vendimet për kufijtë e fortë buxhetor. Nëse propozimi apo opsioni aprovet (në parim) nga Bordi i Drejtorve gjatë këtij procesi fillestar të shqyrtimit të prioriteteve, drejtoria do të bëjë kërkesën më të hollësishme, si pjesë e materialit buxhetor, në fazat e mëvonshme të procesit buxhetor.

Hapi 2: Dorëzimi i buxhetit

Dorëzimet e materialeve buxhetore janë mjete përmes të cilave drejtoritë bëjnë prezantimin e vlerësimeve të tyre buxhetore dhe propozimeve të hollësishme të politikave të reja si dhe opsioneve për kursime në kontekst të strategjisë afatmesme fiskale (dhe në pajtim me kufijtë fillestar buxhetor). Dorëzimi buxhetor duhet të dizajnohet për të thjeshtësuar mbledhjen e informatave .Me shfrytëzimin e vlerësimeve të hershme, dhe duke njohur faktin që shumica e programeve komunale vazhdojnë nga një vit në tjetrin, në fokus të marrjes së vendimeve rreth buxhetit do të jenë propozimet për programet shpenzuese të reja dhe/apo plotësuese si dhe ato që u nënshtrohen kursimeve potenciale në kontekst të pozitës aktuale fiskale.

Hapi 3: Dëgjimet buxhetore

Kur të ketë kaluar afati kohor i specifikuar me Qarkoren Interne Buxhetore Komunale 1, 2, ZKF do të shqyrtojë buxhetet e propozuara që janë dorëzuar nga njësitë funksionale. Drejtoritë dhe sektorët do të mbajnë seanca dëgjimore me qëllim të shqyrtimit dhe të kuptuarit të buxheteve të propozuara, me qëllim të përpjekjes për zgjidhjen e çështjeve dhe shqetësimeve lidhur me buxhetet e propozuara, veçmas për sa i përket pajtueshmërisë së tyre me kufijtë fillestar specifik të drejtorive . Qytetarët do të njoftohen me kohë rreth dëgjimeve buxhetore (dy javë para mbajtjes) përmes shtypit ditor,web-faqes se Komunes ,mediave elektronike dhe njoftimeve publike.

Koha e mbajtjes së dëgjimeve buxhetore:

Dëgjimet buxhetore me qytetarë mbahen në sallën e Kuvendit të Komunës:

- 1. Më 04 Korrik 2025, ora 10:00**
- 2. Më 18 Korrik 2025, ora 10:00**
- 3. Më 22 Gusht 2025, ora 10:00**

Hapi 4: Shqyrtimi i buxhetit komunal

Kur Kryetari, së bashku me drejtorët e drejtorive, të ketë aprovuar buxhetin e propozuar komunal për tri vitet e ardhshme fiskale, përfshirë këtu dhe dokumentet përcjellëse ashtu si kërkohet nga MEF, atëherë Kryetari bën dorëzimin e dokumenteve të buxhetit të propozuar në KPF dhe në Kuvendin e Komunës. Dokumentacioni Përmbledhës i Buxhetit për publikim, shpërndarje dhe shfrytëzim nga ana e Kuvendit të Komunës, dhe opinionit publik gjithashtu, do të dorëzohet së bashku me dokumentacionin e detajuar të buxhetit. Kuvendi bën shqyrtimin e tyre në takimin e rregullt të radhës, apo në ndonjë takim special të ftuar më herët, me qëllim të shqyrtimit të atyre dokumenteve. Rekomandohet që Kuvendi i Komunës të organizojë takim të paralajmëruar në mënyrë adekuate, ku kërkohet nga opinioni publik, kontributi i tyre në lidhje me buxhetin, si dhe shqyrtimin dhe aprovimin e tij. Ky takim duhet të jetë i mbuluar nga mediat, buxheti publik të adresohet nga ZKF dhe Kryetari i Kuvendit të Komunës, ndërsa rekomandohet që të jetë ky një takim i hapur me publikun, në përputhje me Rregulloret.

10.Kalendari kohor

Organizatat buxhetore të nivelit lokal duhet t'i përmbahen këtij kalendari kohor në përgatitjen e propozim buxhetit:

- 30 qershor: Aprovimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore Komunale,
- 30 shtator: Aprovimi i propozim-buxhetit komunal për vitin 2026-2028 nga Kuvendi Komunal,
- 30 shtator: pas aprovimit të propozim-buxhetit nga Kuvendi Komunal, komunat janë të obliguara të dorëzojnë në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve. dokumentet si në vijim:
- Shkresa përcjellëse bazuar në aprovimin e propozim-buxhetit nga Kuvendi Komunal (nënshkruar nga Kryetari i Komunës).
- Vendimi i Kuvendit Komunal mbi aprovimin e propozim-buxhetit komunal për vitin 2026-2028, përfshirë projektet kapitale shumëvjeçare.

- Tabelat e buxhetit komunal (BDMS-së dhe PIP):
- Tabela 4.1 - plani i ndarjeve buxhetore të shpenzimeve për vitin 2026-2028 (kopje e shtypur prej SZHMB, vulosur si dhe nënshkruar nga Kryetari i Komunës dhe ZKF),
- Tabela 4.2 - financimi i projekteve kapitale për vitin 2026 dhe projekteve kapitale shumëvjeçare për vitin 2027-2028 (shtypur nga sistemi PIP, vulosur si dhe nënshkruar nga Kryetari i Komunës dhe ZKF),
- Tabela 4.3 - plani afatmesëm i të hyrave totale të buxhetit komunal nga grantet qeveritare dhe të hyrat vetanake (shtypur nga BDMS, vulosur si dhe nënshkruar nga Kryetari i Komunës dhe ZKF),
- Tabelat e Buxhetimit sipas performancës

Planifikuese e Buxhetit
Shqipe Islami

Drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa
Ramadan Jashanica